



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

NJOFTIM

PËR PROVIMIN E DIGJITALIZUAR PËR PUNËSIMIN SI TEKNIK I SHKENCAVE

MJEKËSORE

Ju bëjmë me dije se duke filluar nga java e dytë e muajit Tetor 2021, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet provimi i digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore. Në vijim, në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al, do të publikohet kalendari me datat dhe oraret përkatëse për kandidatët e regjistruar.

Në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe në vijim të masave parandaluese të përhapjes së tij, nëpërmjet urdhrave të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, provimet do të zhvillohen duke zbatuar me përpikmëri rregullat e mëposhtme:

Qendra e Shërbimeve Arsimore është përgjegjëse për ofrimin e sigurisë maksimale dhe kushteve të përshtatshme higjieno - sanitare, duke ofruar:

- pastrim dhe dezinfektim të ambienteve të provimit me solucione dezinfektuese të miratuara, përpara dhe pas çdo seance provimi;
- pastrim dhe dezinfektim të pajisjeve fizike të ambienteve të provimit, si: kompjuterët, pajisjet elektronike, karriget, tavolinat, etj;
- vendosje të solucioneve dezinfektuese në hyrje të çdo ambienti provimi;
- respektim të distancës 1,5 – 2 metër ndërmjet kandidatëve gjatë gjithë proceseve të zhvillimit të provimit;
- mundësinë e kryerjes së provimit në kabina të veçanta për secilin kandidat, duke respektuar distancën fizike nga njëri – tjetri;
- pajisjen me mjetet e duhura mbrojtëse si maska dhe doreza plastike, të stafit të institucionit dhe personave të jashtëm, të përfshirë në proceset e zhvillimit të provimit.

Gjatë paraqitjes për pjesëmarrje në provim, kandidati duhet të ketë parasysh dhe të zbatojë rregullat e mëposhtme:

1. të paraqitet pranë QSHA-së, i pajisur me mjetet mbrojtëse, maskë dhe doreza plastike;
2. të zbatojë ruajtjen e distancës fizike 1,5 – 2 metër nga kandidatët e tjerë.;
3. të ketë me vete vetëm dokumentet e kërkuara dhe mjetin e identifikimit;
4. të ketë me vete stilolaps për nënshkrimin e deklaratës dhe rezultatit të provimit;
5. të mos ketë me vete celularë, çanta dhe sende të tjera personale të panevojshme për zhvillimin e provimit.
6. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së **30 minuta përpara** orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
- Faturën origjinale të pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës së provimit për llogari të QSHA-së. Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun: http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/fature_punesim_shkenca_teknike.pdf

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në provim.

7. Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet **mbajtja** dhe **përdorimi** i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
- firmos procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikojnë paraprakisht identitetin dhe orarin e pjesëmarrjes në provim, në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën www.qsha.gov.al, “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, “Lista e kandidatëve për provimin e digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore”.

Në lidhje me orarin e pjesëmarrjes në provim, ju bëjmë me dije se orari do të jetë i përcaktuar për çdo kandidat dhe nuk do të ketë ndryshime orari përtej planifikimit të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së.

Ju urojmë suksese!